



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.56/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së bollbordit në objekt publik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 700 (shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 24.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 24.09.2017, në rrugën “Ahmet Kaçiku” në Ferizaj, monitoruesit e tyre kanë hasur në billbord të kandidatit për kryetar të Komunës nga Partia Demokratike e Kosovës, të vendosur në objekt publik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që ka vendosur billbordin të kandidatit për kryetar të Komunës. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Partia Demokratike e Kosovës, të datës 25.09.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se është bërë nga aktivistë të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, dhe se pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku është larguar billbordi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se billbordi i kandidatit për kryetar të Komunës nga radhët e subjektit politik PDK, është vendosur në objekt publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që billbordi i kandidatit për kryetar të Komunës të subjektit politik PDK-së, është vendosur në objekt publik. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik PDK, në përgjigjen në ankesë të datës 25.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti billbordi i kandidatit për kryetar të Komunës së këtij subjekti politik është vendosur në objekt publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektin politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë billbordin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 56/2017 më datën 26.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.